



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.Dh.Shk.II.nr.1221/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit Kosova Elektrik Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810834219 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Muharrem Cani”, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokatët Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi me zyre në Prishtinë, kundër debitorit “Berto” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810690372 dhe me seli në Vushtrri, rr. “Adnan Shyti” p.n., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Engjell Rexhepi me zyre në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1689/22 të datës 22.02.2024, me datë **01.11.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kosova Elektrik Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1689/22 të datës 22.02.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1689/22 të datës 22.02.2024, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Berto” Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr. 158/2022 i datës 07.04.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Z. Mulhaxha, është shfuqizuar. Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (me pretendime sikur në ankesë), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës

Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1689/22 të datës 22.02.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se Aktvendimi KPPP.nr.1689/22 të datës 22.02.2024 është i drejtë andaj, ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që të njëjtin ta vërtetoj ndërsa ankesën e kreditorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Berto” Sh.P.K., me datë 24.12.2021 ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 158/2022 të datës 07.04.2022 duke lejuar përmbartimin mbi bazën e dokumentit faturë nr. 9/19 të datës 30.04.2019, ashtu që është detyruar debitori “Berto” Sh.P.K., që në emër të borxhit të papaguar nga fatura e lartcekur, t’ia paguaj kreditorin shumën prej 17,620.00 EUR (me shkronja: shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet euro) me kamatë ligjore prej 8% nga arritja për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit, fillimisht për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me gjyqëvarësi, pasi që lidhur me çështjen e njëjtë dhe në mes palëve të njëjta, gjendet në zhvillim e sipër procedura sipas ankesës në Gjykatën e Apelit të Kosovës ndaj aktvendimit CPP.nr. 282/21 të datës 08.10.2021, ku me këtë aktvendim, në lidhje me faturën e njëjtë, është pranuar prapësimi i debitorit, është shfuqizuar urdhri për lejimin e përmbartimit dhe është hudhur propozimi për përmbartim, andaj ka theksuar se ekzistimi i gjyqëvarësisë e bën të palejueshëm propozimin për përmbartim në rastin konkret. Ka shtuar tutje se kreditori i ka përmbushur të gjitha obligimet që ka pasur ndaj debitorit sipas kontratës për ofrimin e shërbimeve të datës 24.12.2018, kjo pasi që sipas kësaj kontrate, detyrimi i debitorit ka qenë në vlerë prej 43,981.00 EUR, ndërsa debitori ka përmbushur detyrim në vlerë më të madhe, konkretisht në shumë prej 51,371.48 EUR. Për më

tepër ka shtuar se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi nuk përmban vulën e debitorit, andaj e njëjta nuk është e përshtatshme për përmbartim. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të pranohet, urdhri për lejimin e përmbartimit të anulohet, ndërsa propozimi për përmbartim të hudhet për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimi ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke sqaruar se në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me gjyqëvarësi kjo pasi që kreditori, në pajtim me nenin 42 të LPP-së, ka tërhequr propozimin për përmbartim ndaj debitorit ndërsa Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu, me konkluzionin PPP.nr.552/19 të datës 23.12.2021 ka përfunduar procedurën përmbartimore. Në këtë kuptim ka shtuar se kreditori, në pajtim me nenin 43, par.3 të LPP-së ka paraqitur përsëri propozim për përmbartim i cili është lejuar sipas urdhrin përmbartimor P.nr. 586/21 të datës 24.12.2021, i cili është objekt shqyrtimi në këtë procedurë. Në anën tjetër, ka deklaruar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se i njëjti ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj kreditorit, kjo pasi që kreditori ka lëshuar faturën nr. 9/2019 të datës 30.04.2019 në vlerë prej 22.620.00 EUR, ndërsa debitori, ka bërë vetëm pagesë të pjesshme të kësaj fature në vlerë prej 5,000.00 EUR, dhe atë me datë 16.08.2019, pagesë kjo e cila i është referuar faturës së lartcekur. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1689/22 të datës 22.02.2024, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Berto” Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 158/2022 i datës 07.04.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Z. Mulhaxha, është shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti faturë nr. 9/19 e datës 30.04.2019 në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbartim është bashkangjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm.”

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, se lëshuar nga kreditori, i cili nuk përmban elementet qe kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* e po që se i referohemi propozimit për përmbartim të ushtruar nga ana e kreditorit, rezulton se i njëjti është bërë duke u referuar në dokumentin përmbartues, i cili nuk është dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar, siç përcakton ligji, por është dorëzuar në kopje, andaj si e tille nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbartimit.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit por te njëjta mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbattoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr.1221/24, me datë 10.10.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**